

FERIZAJ
KRYEQENDRORE
2017

C.nr.547/17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Misin Frangu dhe zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri, në çështjen juridike, sipas padisë së paditësit [REDAKTUAR] nga Shtimja, Rr.' [REDAKTUAR]' nr. [REDAKTUAR] të cilin me autorizim e përfaqëson av. [REDAKTUAR] nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna Shtime - Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson [REDAKTUAR] për pagesën e tri pagave përcjellëse dhe tri pagave jubilarë, në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit dhe të të paditurit, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 21.02.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit [REDAKTUAR] nga Shtimja, dhe **DETYROHET** e paditura Komuna në Shtime - Drejtoria e Arsimit, që paditësit, në emër të tri pagave përcjellëse dhe tri pagave jubilarë me rastin e pensionimit, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 2,733.24 € (dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre euro e njëzetë e katër cent) me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.
- II. **DETYROHET** e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 414.00 €, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.
- III. **OBLIGOHET** paditësi që të paguaj taksën gjyqësore shtesë për paraqitje të padisë së gjykatë, në shumë prej 20 €, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Paditësi me datë 10.07.2017, ka parashtruar padi dhe më vonë gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka precizuar padinë kundër të paditurës, ku ka kërkuar pagesën e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit në shumë prej 1,366.62 € dhe pagesën e tri pagave jubilarë në shumë prej 1,366.62 €, e që në shumë totale bëjnë 2,733.24 €.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij ka deklaruar se me rastin e pensionimit, i'u ka drejtuar me kërkesë me shkrim të paditues për pagimin e tri pagave përcjellëse dhe tri pagave jubilarë, ashtu siç parashihet me Kontratën Kolektive në lëminë e arsimit, por se kërkesa e tij ishte refuzuar me arsyetimin se e paditura nuk ka vijë bugjetore për pagimin e tyre.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe precizimit në padi dhe se nga provat e administruara shihet se paga mujore e paditësit në tre muajt e fundit para pensionimit ka qenë e pandryshuar në lartësi prej neto 455.64 € në muajt, gjë e cila u vërtetua nga shkresat e lëndës, andaj, kërkojmë që tri pagat përcjellëse dhe tri pagat jubilarë të pagohen së bashku me kamatën ligjore prej 8% dhe njëherit i propozojmë gjykatës që ta miratojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke përfshirë edhe pagimin e shpenzimeve të procedurës për përfaqësim, në shumë prej 530.00 €.

I autorizuari i të paditues, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi duke kontestuar kërkesëpadinë e paditësit sa i përket pagave përcjellëse dhe atyre jubilarë, me arsyetimin se Komuna në Shtime nuk ka fonde të tilla e as linjë bugjetore për pagesën e pagave përcjellëse dhe pagave jubilarë, andaj i propozon gjykatës që padinë e paditësit ta refuzojnë si të pabazuar.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes kontestimore, për aq sa palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, ka administruar provat si vijon: *Shkresën zyrtare nr.02/24 e dt. 06.02.2018 e lëshuar nga Komuna e Shtimes; shkresa zyrtare nr.05/319 e dt.15.05.2017 e lëshuar nga Komuna e Shtimes; vërtetimi me nr. protokoll:338/1 e dt.20.02.2017 i lëshuar nga Komuna e Shtimes; vërtetimi me nr. protokoll: 582 i dt.23.06.2017 i lëshuar nga Shkolla Filllore "Emin Duraku" nga Shtimja; vendimi i dt.24.02.2017 i lëshuar nga Qeveria e Kosovës – MPMS; vërtetimi nr.900/1 i dt.10.07.2017 i lëshuar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës; vendimi nr.05/62 i dt.09.02.2017 i lëshuar nga Komuna e Shtimes; vendimi nr.05/610/01/14498/17 i dt.22.05.2017 i lëshuar nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Sektorin e Arsimit në Komunën e Shtimes; qarkorja nr.2 njësia 01 me nr. protokoll:1922 e dt.01.08.2016; lista e pagave nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për tre muajt e fundit për paditësin.*

Gjykata nga provat e administruara dhe nga deklaratat e palëve ndërgjyqëse ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se paditësi ka qenë i punësuar te e paditura prej datës 05.02.1977 e deri në momentin e pensionimit me datë 22.02.2017; se paditësi ka përvojë pune te e paditura mbi 42 vite dhe për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension – fakte të cilat nuk janë kontestuese nga e paditura; se paditësi në tre muajt e fundit para pensionimit ka realizuar pagë mujore në shumë prej 455.64 €; se paditësi pas pensionimit ka bërë kërkesë me shkrim te e paditura për realizimin e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë, mirëpo kërkesa i ishte refuzuar nga e paditura me arsyetimin se Komuna e Shtimes nuk ka një vijë

të tillë buxhetore për të ekzekutuar një kërkesë të tillë dhe gjithashtu nuk ka mjete financiare të alokuara për këtë qështje nga Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës.

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadiës është bazuar në faktin se me Kontratën Kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 53 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët ndërsa zbatohet prej 01 Janar të viti 2015, ndërsa me nenin 51 të kësaj kontrate zbatohet në rastin kur ka implikime financiare.

Në pjesën hyrëse, respektivisht, në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësi e ka shfrytëzuar një të drejtë pasi që i njëjti përfiton nga kjo kontratë për faktin se me rastin e daljes së tij në pension kontrata kolektive ka qenë në fuqi e cila nuk është kontestuar nga ana e të paditurës.

Në nenin 36 par. 9 pika 9.1 dhe 9.23 të Kontratës Kolektive për të Punësuarit në Arsimin Fillor dhe të Mesëm është përcaktuar që punëtori ka të drejtë në shpërblim jubilar për 10 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page bazë, për 20 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit, në vlerë prej dy pagave bazë dhe për 30 vite të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit, në vlerë prej tri pagave bazë. Sipas Kontratës Kolektive punëdhënësi i fundit është ai që e paguan shpërblimin jubilar, ku shpërblimi jubilar paguhet në afat prej 1 muaji pas plotësimit të kushteve nga kjo pikë, çka do të thotë se e paditura është dashur që me rastin e daljes në pension, paditësit brenda 1 muaji sipas nenit 36 par. 9 pika 9.5 t'ia paguajë tri paga jubilarë me që i ka plotësuar këto kushte dhe ka pasur përvojën e punës mbi 30 vjeçare, dhe si e tillë, ka qenë obligim i të paditurës që të bëjë pagesën e tyre pa pasur nevojë as për t'i paraqitur të paditues ndonjë kërkesë qoftë gojore apo me shkrim.

Kurse neni 36 par. 10 të Kontratës Kolektive për të Punësuarit në Arsim Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, është përcaktuar se punëtori ka të drejtë që me rastin e pensionimit në pagesat përcjellëse në lartësi të tri pagave bazë sipas mesatares së tri pagave bazë të fundit të punëtorit, e në rastin konkret Gjykata ka marr parasysh që tri pagat e fundit bazë të punëmarrësit kanë qenë të pandryshuara në shumë prej 455.64 € në muaj.

Pretendimet e përfaqësuesit të të paditurës se kërkesën e paditësit për kompensimin e pagave përcjellëse dhe atyre jubilarë duhet të refuzohet për faktin se e paditura nuk ka pasur fonde të veçanta që ti përmbushë këto detyrime, këto pretendime për Gjykatën janë të pa bazuara për faktin se me nenin 2 të kësaj kontrate të gjitha DKA, në rastin konkret e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë Kontratë Kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin për këto

raste, e jo të thirret se nuk ka mjete të destinuara për këto raste, andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është tek e paditura e jo tek paditësi.

Nga arsytet e lartçekura, konform nenit 143 i LPK-së dhe nenit 36 i Kontratës Kolektive për Arsim Parauniversitar e datës 11.04.2014 Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, ndërsa lidhur me kamatën ligjore, Gjykata ka vendosur konform nenit 382 par.2 i LMD-së.

Gjykata e obligoi paditësin për pagimin e taksës gjyqësore shtesë për paraqitje të padisë, në shumë prej 20 €, bazuar në nenin 12.1 i UA nr.1/2017 të KGJK-së për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Për shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi konform nenit 452 par.1 dhe nenit 453 të LPK-së, duke e obliguar të padituren që t'ia paguajë paditësit shpenzimet në shumë të përgjithshme prej 414.00 € dhe atë për paraqitje të padisë në gjykatë shumë prej 40 €, për përfaqësim në dy seanca të mbajtura nga 135 € apo 270 € së bashku, si dhe përpilimin e padisë në shumë prej 104 €, kurse pjesa tjetër e shpenzimeve të kërkuara refuzohet si e pabazuar.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.547/17 dt. 21.02.2018



Gjyqtari,
Mish Frangu

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC

→ Acnr. 2727/18

Më
Dana 27. 08 20 18



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të kopjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.